**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada – Government***
*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*
*Ministarstvo obrazovanja, nauke,tehnologije i inovacije*
*Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

---

# UDHËZIM ADMINISTRATIV( MASHTI) NR.__07__/2021 PËR KALENDARIN E VITIT SHKOLLOR 2021/2022

# ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MESTI) NO. __07__/2021 FOR SCHOOL YEAR CALENDAR 2021/2022

# ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MONTI) BR.__07__/2021 ZA KALENDAR ŠKOLSKE GODINE 2021/2022

| | | |
|---|---|---|
| **Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit,**<br>Në mbështetje të nenit 5 paragrafit 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17, 16 shtator 2011), nenit 8, paragrafit 1, shtojcës 1 pikës 7 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative (GZ, nr. 03/2013, dt. 16.05.2013), nxjerr: | **The Minister of Education, Science, Technology and Innovation**,<br>Pursuant to Article 5 paragraph 2 subparagraph 2.1 of the Law on Pre-University Education in the Republic of Kosova (Official Gazette No. 17, 16 September 2011), Article 8, paragraph 1, Annex 1 point 7 of Regulation (GRK) no. 02/2021 on Areas of Administrative Responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries as well as Administrative Instruction no. 03/2013 on standards for drafting normative acts (OG, no. 03/2013, dated 16.05.2013), issues: | **Ministar Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije**<br>U skladu sa članom 5. stav 2. podstav 2.1 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo (Službeni glasnik br. 17, 16. septembar 2011. godine), članom 8. stav 1, Aneks 1 tačka 7 Uredbe (VRK) br. 02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, kao i Administrativno uputstvo br. 03/2013 o standardima za izradu normativnih akata (SG, br. 03/2013, od 16.05.2013.), Izdanjaje: |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHTI) NR.______/2021 PËR KALENDARIN E VITIT SHKOLLOR 2021/2022** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MESTI) NO. ______/2021 FOR SCHOOL YEAR CALENDAR 2021/2022** | **ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MONTI) BR.________/2021 ZA KALENDAR ŠKOLSKE GODINE 2021/2022** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**The purpose** | **Član 1**<br>**Cilj** |
| Ky Udhëzim administrativ, ka për qëllim të përcaktojë fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor, respektivisht të vitit mësimor, sipas niveleve, pushimin dimëror, pushimin pranveror, festat publike për nxënësit e shkollave fillore, klasave parafillore, shkollave të mesme të ulëta, shkollave të mesme të larta, institucionet parashkollore dhe qendrat burimore për mësim dhe | This Administrative Instruction aims to determine the beginning and end of the school year, respectively the academic year, according to levels, winter break, spring break, public holidays for primary school students, pre-primary classes, lower secondary schools, higher secondary schools, preschool institutions and resource centres for teaching and counselling. | Ovo Administrativno uputstvo ima za cilj da odredi početak i kraj školske godine, odnosno akademske godine, po nivoima, zimskim raspust, prolećni raspust, državni praznici za učenike osnovnih škola, predškolske razrede, niže srednje škole, više srednje škole, predškolske institucije i resorni centri za učenje i savetovanje. |

| | | |
|---|---|---|
| këshillim. | | |
| **Neni 2**<br>**Viti shkollor** | **Article 2**<br>**School year** | **Član 2**<br>**Školska godina:** |
| Viti shkollor 2021/2022, do të fillojë me 1 shtator 2021 dhe do të përfundojë me 31 gusht 2022. | The school year 2021/2022 will begin on September $1^{st}$, 2021 and will end on August $31^{st}$, 2022. | Školska godina 2021/2022, počinje 1 septembra 2021 i završava 31 avgusta 2022. |
| **Neni 3**<br>**Periudha e parë** | **Article 3**<br>**First period** | **Član 3**<br>**Prvi period** |
| Periudha e parë, fillon me 1 shtator 2021 dhe përfundon me 24 dhjetor 2021. | The first period begins on September $1^{st}$, 2021 and ends on December $24^{th}$, 2021. | Prvi period počinje 1 septembra 2021 i završava 24 decembra 2021. |
| **Neni 4**<br>**Periudha e dytë** | **Article 4**<br>**Second period** | **Član 4**<br>**Drug period** |
| Periudha e dytë, fillon me 10 janar 2022 dhe përfundon me 01 prill 2022. | The second period begins on January $10^{th}$, 2022 and ends on April 01, 2022. | Drugi period počinje 10 januara 2022 i završava se 01 aprila 2022. |
| **Neni 5**<br>**Periudha e tretë** | **Article 5**<br>**Third period** | **Član 5**<br>**Treći period** |
| 1. Periudha e tretë fillon me 12 prill 2022 dhe përfundon me: | 1. The third period begins on April $12^{th}$, 2022 and ends on: | 1.Treći period počinje 12 aprila 2022. godine i završava dana: |
| 1.1. 13 maj 2022, për nxënësit të cilët e përfundojnë shkollën e mesme të lartë klasën e 12-të (maturantët). | 1.1. $13^{th}$ May, 2022, for students who complete 12th grade of higher secondary school (graduates). | 1.1. 13. maja 2022. godine za učenike koji završavaju višu srednju školu 12-ti razred (maturanti); |
| 1.2. 3 qershor 2022, për nxënësit e | 1.2. June $3^{th}$, 2022, for students in | 1.2. 3 jun 2022, za učenike koji |

| | | |
|---|---|---|
| klasave 9, 10 dhe 11-të. | grades 9, 10 and 11. | završavaju 9, 10 i 11 razred; |
| 1.3. 17 qershor 2022, për nxënësit e klasave 1-8 dhe fëmijët parafillor. | 1.3. June 17th, 2022, for students in grades 1-8 and pre-primary children. | 1.3. 17 jun 2022, za učenike koji završavaju 1 - 8 razred i deca predškolskog; |
| **Neni 6**<br>**Praktika profesionale** | **Article 6**<br>**Professional practice** | **Član 6**<br>**Profesionalna prakse** |
| 1. Përveç mësimit të rregullt, nxënësit do të kenë edhe forma tjera të mësimit siç është mësimi praktik dhe praktika profesionale. | 1. In addition to regular teaching, students will have other forms of teaching such as practical teaching and professional practice. | 1. Pored redovne nastave, učenici će imati i druge oblike učenja kao što su praktična nastava i profesionalna praksa. |
| 2. Drejtorët e të gjitha shkollave profesionale, janë të detyruar që në planin vjetor të punës ta caktojnë kohën e mbajtjes së praktikës profesionale. | 2. The principals of all vocational schools are obliged that in the annual work plan to specify the time of holding the professional internship. | 2. Direktori svih profesionalnih škola dužni su da u godišnjem planu rada odrede vreme održavanje profesionalne prakse. |
| 3. Obligohen qendrat burimore të ofrojnë praktikë profesionale për nxënësit me aftësi të kufizuar. | 3. Resource centers are obliged to provide professional practice for students with disabilities. | 3. Obavezuju se resorni centri da omoguće profesionalnu praksu za učenike sa ograničenim sposbnostima. |
| **Neni 7**<br>**Pushimet** | **Article 7**<br>**Holidays** | **Član 7**<br>**Odmori** |
| 1. Pushimi dimëror, fillon më 28 dhjetor 2021 dhe mbaron më 06 janar 2022. | 1. The winter holidays begin on December 28th, 2021 and ends on January 06th, 2022. | 1. Zimski odmor počinje 28 decembra 2021 i završava 06 januara 2022. |
| 2. Pushimi pranveror, fillon më 04 prill 2022 dhe mbaron më 8 prill 2022. | 2. The spring holidays begins on April 4st, 2022 and ends on April 8th, 2022. | 2. Prolećni odmor počinje 04 aprila 2022 i završava 8 aprila 2022. |

| Neni 8<br>**Festat publike, ditët kur pushohet** | **Article 8**<br>**Public holidays, non-working days** | **Član 8**<br>**Državni praznici, dani odmora** |
|---|---|---|
| 1. 28 nëntor 2021, Dita e Shqiptarëve, Dita e Pavarësisë së Shqipërisë, ditë pushimi 29.11.2021. | 1. November 28th, 2021, Albanians Day, Independence Day of Albania, non-working day 29.11.2021. | 1. 28 novembra 2021, Dan Albanaca Dan nezavisnosti Albanije, neradni dan 29.11. 2021 |
| 2. 25 dhjetor 2021, Krishtlindjet Katolike, ditë pushimi 27.12.2021 | 2. December 25th, 2021 Catholic Christmas, non-working day 27.12.2021. | 2. 25 decembar 2021, Katolički Božić. Neradni dan 27.12.2021. |
| 3. 17 shkurt 2022, Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. | 3. February 17th, 2022, Independence Day of the Republic of Kosova. | 3. 17 februar 2022, Dan nezavisnosti Republike Kosova. |
| 4. 9 prill 2022, Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ditë pushimi 11.04.2022. | 4. April 09th, 2022, Constitution Day of the Republic of Kosova, non-working day 11.04.2022. | 4. 9 april 2022, Dan ustavnosti Republike Kosov, neradni dan 11.04.2022. |
| 5. 17 prill 2022, Pashkët Katolike, ditë pushimi është më 18.04.2022. | 5. April 17th, 2022, Catholic Eastern, non-working day 18.04.2022. | 5. 17 april 2022, Katolički Uskrs, neradni dan je 28.04.2022. |
| 6. 24 prill 2022, Pashkët Ortodokse, ditë pushimi është më 25.04.2022. | 6. May 24th, 2022, Orthodox Eastern, non-working day is 25.04.2022. | 6. 24 april 2022, Pravoslavni uskrs, neradni dan 25.04.2022. |
| 7. 1 maj 2022, Dita Ndërkombëtare e Punës, ditë pushimi është 02.05.2022. | 7. May 1st, 2022, International Labour Day, non-working day is 02.05.2022. | 7. 1 maj 2022, Međunarodni dan rada neradni dan je 02.05.2022 |
| 8. 2 maj 2022, Fitër Bajrami, ditë pushimi është më 03.05.2022. | 8. May 9th, 2021, Eid al-Fitr, non-working day is 03.05.2022. | 8. 02 maj 2022, Fiter Bajram, neradni dan je 03.05.2022. |
| 9. 9 maj 2022, Dita e Evropës. | 9. May 9th, 2022, Day of Europe. | 9. 9 maj 2022, Dan Evrope, |
| 10. 12 qershor 2022, Dita e Paqes, ditë pushimi është më 13.06.2022. | 10. June 12th, 2022, Day of Peace, non-working day is 13.06.2022. | 10. 12 maj 2022, Dan mir, neradni dan je 13.06.2022 |

| **Neni 9**<br>**Ditët dhe javët e obliguara të mësimit dhe të punës** | **Article 9**<br>**The compulsory days and weeks of learning and labour** | **Član 9**<br>**Dani i nedelje obavezni za održavanje nastave i rada** |
|---|---|---|
| 1. Për nxënësit e shkollës së mesme të lartë-maturantët, janë të obliguara 160 ditë mësimi 32 javë. | 1. For secondary higher school students – graduates are obliged in 160 learning days – 32 weeks | 1. Za učenike više srednje škole - maturante, obavezno je 160 nastavnih dana 32 nedelje. |
| 2. Për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11-të, janë të obliguara, 175 ditë mësimi 35 javë. | 2. For students of grades 9, 10 and 11 – are obliged, 175 learning days 35 weeks. | 2. Za učenike 9, 10. i 11-tog. razreda obavezana su 175 dana nastave 35 nedelja. |
| 3. Për nxënësit e klasave 1- 8 dhe fëmijët parafillor, janë të obliguara 184 ditë mësimi 37 javë. | 3. For students of grades 1-8 and pre-primary students are obliged 184 learning days, 37 weeks. | 3. Za učenike 1-8 razred i deca predškolskog, obavezna su 184 dani nastave 37 nedelje. |
| 4. Institucionet parashkollore, duhet të marrin për bazë festat zyrtare në pajtim me nenin 8 të këtij udhëzimi. | 4. Preschool institutions must take into account official holidays in accordance with Article 8 of this instruction. | 4. Predškolske institucije treba da imaju u vid državne praznike u skladu sa članom 8. ovog uputstva. |
| 5. Duke u mbështetur në ligjin e punës, institucionet parashkollore pushimin veror e planifikojnë jo më shumë se dy javë brenda periudhës 1 korrik -15 gusht. | 5. Based on the labour law, preschool institutions plan summer vacation no more than two weeks within the period July 1- August 15. | 5. Na osnovu zakona o radu, predšskolske institucije letnji odmor planirajune više od dve nedelje u periodu od 1. jula do 15. avgusta, |
| 5.1. Pushimi i stafit rregullohet sipas ligjit të punës ndërsa pushimi kolektiv brenda periudhës së përcaktuar në pikën 5 merret për arsye të dezinfektimit dhe pastrimit të institucionit parashkollor dhe përgatitjes për vitin vijues. | 5.1. The staff holiday is regulated according to the labour law while the collective holiday within the period defined in point 5 is taken for reasons of disinfection and cleaning the preschool institution and preparation for the following year | 5.1. Odmor osoblja uređuje se prema zakonu o radu, dok kolektivni odmor u periodu utvrđen tačkom 5 uzima se dizenfekcija i čišćenje predškolskih institucija i priprema za narednu godinu. |
| 6. Në Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim me konvikt, në rast se festa është | 6. In resource centres for learning and counselling with dormitory, if the holiday is | **6.** U Resornim centrima za učenje i savetovanje sa domovima za stanovanje, |

| | | |
|---|---|---|
| gjatë ditëve të punës, u lejohet të planifikojnë zëvendësimin e mësimit, pa humbur nga ditët dhe javët e obliguara për mësim. | during working days, they are allowed to plan the substitution of the lessons, without losing the compulsory days and weeks of lessons. | ako je praznik tokom radnih dana, dozvoljavase planiranje zamena nastave, bez gubljenja obaveznih dana i nedelja za nastavu. |
| 7. Për çdo ndryshim të kalendarit shkollor, MASHTI merr vendim të veçantë. | 7. For any changes to the school calendar, special decision is taken by MESTI. | 7. Za svaku promenu školskog kalendara, MONTI donosi posebnu odluku. |
| **Neni 10**<br>**Dispozitat shfuqizuese** | **Article 10**<br>**Repealing provisions** | **Član 10**<br>**Van snažne odredbe** |
| Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ, shfuqizohet UA me nr. 85/2020. | With the entry into force of this Administrative Instruction is repealed the AI no. 85/2020. | Stupanjem na snagu Administrativnog uputstva, stavlja van snagu AU br. 85/2020. |
| **Neni 11**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 11**<br>**Entry into force** | **Član 11**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministrja. | This Administrative instruction enters into force seven (7) days after its signing by the Minister. | Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisivanja od strane Ministra. |
| **Arbërie Nagavci**<br>**Ministre**<br>**Dt.** 20 . 03 . 2021 | **Arbërie Nagavci**<br>**Minister**<br>**Date.** ___ . ___ . ___ | **Arbërie Nagavci**<br>**Ministarka**<br>**Dat.** ___ . ___ . ___ |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada – Government***
*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Inovation*

KALENDARI PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022
01.09.2021 - 31.08.2022

| Muaji | Periudha e ditëve të mësimit | Numri i ditëve të mësimit | Festat | Mbarimi i vitit mësimor |
|---|---|---|---|---|
| Shtator | 1-30 | 22 ditë | | |
| Tetor | 1-29 | 21 ditë | | |
| Nëntor | 1-30 | 21 ditë | *Dita e shqiptarëve (Dita e Pavarësisë së Shqipërisë) 28.11.2021 | |
| Dhjetor | 1-24 | 18 ditë | *Krishtlindjet Katolike 25.12.2021 | |
| | | | Përfundimi i periudhës së parë | |
| Pushimi Dimëror | | | *Viti i Ri 2022 (01.01.2022 dhe 02.01.2022)<br>* Krishtlindjet Ortodokse (07.01.2022)<br>28.12.2021 - 6.01.2022 | |
| Janar | 10-31 | 16 ditë | | |
| Shkurt | 1-28 | 19 ditë | *Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës 17.02.2022 | |
| Mars-Prill | 01.03-01.04 | 24 ditë | | |
| Pushimi Pranveror | | | Përfundimi i periudhës së dytë (04.04.2022-08.04.2022) | |
| Prill | 12-29 | 12 ditë | *Dita e Kushtetutës 09.04.2022<br>* Pashkët Katolike 17 .04.2022<br>* Pashkët Ortodokse 24.04.2022 | |
| Maj | 4-31 | 19 ditë | * Dita Ndërkombëtare e Punës 01.05.2022<br>* Fitër Bajrami 02.05.2022<br>* Dita e Evropës 09.05.2022 | 13 maj<br>Përfundimi i vitit mësimor për Klasën e 12-Maturantët |
| Qershor | 1-17 | 12 ditë | *Dita e Paqes 12.06.2022 | 3 qershor<br>Përfundimi i vitit mësimor për klasën e 9, 10 dhe 11 |
| | | | | 17 qershor<br>Përfundimi i vitit mësimor për Parafillorët dhe klasat 1-8 |

* 28.11.2021  Dita e shqiptarëve (Dita e Pavarësisë së Shqipërisë), ditë pushimi është më 29.11.2021
* 09.04.2022  Dita e Kushtetutës, ditë pushimi është më 11.04.2022
* 17 .04.2022 Pashkët Katolike, ditë pushimi është më 18.04.2022
* 24.04.2022  Pashkët Ortodokse, ditë pushimi është më 25.05.2022
* 01.05.2022  Dita Ndërkombëtare e Punës, ditë pushimi është më 02.05.2022
* 02.05.2022  Fitër Bajrami, ditë pushimi është më 03.05.2022
* 12.06.2022   Dita e Paqes, ditë pushimi është 13.06.2022